

FAZA e DYTË e debateve mbi Projekt-Kushtetutën e Kosovës

Kapitulli mbi Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre

**Koha dhe vendi:** 25 shkurt 2008 / Prizren (Qendra për Integrimin e Komuniteteve Etnike)

**Panelist:** Bajram Latifi dhe Fatmir Fehmiu

**Vërejtjet hyrëse nga Panelistët:**

**Bajram Latifi:** Faleminderit të gjithëve dhe organizatorit që kanë organizuar këtë tubim. Shpresojmë të kemi komente nga ju të cilat do të inkorporohen në Kushtetutë. Para se të filloj, dëshiroj të ju uroj Pavarësinë e Kosovës. Kur flitet për Kushtetutën, ajo është akti më i lartë i një shteti. Për ne është shumë e rëndësishme të dimë se çka përmban, sepse me këtë rregullohen të gjitha pjesët e jetës. Për ne, pakicat janë në një pozitë specifike dhe me këtë Kushtetutë rregullohen marrëdhëniet dhe veprimtaria e tyre. Kur flitet për Kushtetutën, në fazën e parë kemi folur për kërkesat se Kosova ka nevojë për një akt të tillë, mandej hartimi dhe miratimi i Kushtetutës. Në fazën e parë, gjatë diskutimeve me publikun, nuk e kemi pasur Kushtetutën dhe kemi pasur kërkesa pse nuk e kemi përpara. Por nxjerrja e Kushtetutës në kohë moderne e kërkon edhe atë fazë për të diskutuar se çka iu intereson qytetarëve që Kushtetuta të përmbajë. Ky është një Draft-Kushtetutë dhe është bërë publike në momentin kur është shpallur Deklarata e Pavarësisë.

Debatet janë me rëndësi për të dëgjuar komentet e qytetarëve mbi çështjet që kanë të bëjnë me ta, e veçanërisht komunitetet apo pjesa për komunitetet që përmban Kushtetuta. Debatet do të mbahen deri më 2 mars, dhe përderisa ka interesim të shoqatave, komentet mund të dërgohen përmes e-mailit apo faqes së internetit. Me rëndësi është që kjo Kushtetutë të përmbajë atë që është e nevojshme dhe e duhur për të gjithë. Ne kemi konsultuar një numër të madh kushtetutash nga vendet e zhvilluara dhe vendet që kanë kaluar tranzicionin si dhe vendet që janë multietnike siç është Kosova. Poashtu kemi pasur ndihmë edhe nga ekspert të ndryshëm të huaj dhe kemi mbajtur punëtori për këtë çështje.

**Fatmir Fehmiu:** Të nderuar zonja dhe zotërinj, më lejoni të ju uroj ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës në emër të Komisionit. Ky takim është për të diskutuar Draft-Kushtetutën e Kosovës. Sot do të diskutojmë për pjesën - Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre. Komunitetet janë një pasuri e çdo vendi dhe poashtu edhe e Kosovës. Deklarata e Pavarësisë është mirëpritur nga të gjitha vendet e zhvilluara dhe demokratike. Poashtu i është hapur rrugë edhe nxjerrjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në fakt, të drejtat e komuniteteve gjenden dhe rregullohen me kapitullin 2 Parimet Themelore. Pastaj nenet e Kushtetutës në këtë kapitull; neni 58, 59, 60, 61. Duhet thënë se të drejtat ekonomike, qytetare dhe politike janë të përfshira në pjesën 2 ndërsa pjesa 3 përmban të drejtat kolektive. Zhvillimi kulturor dhe arsimimi, emërtimin e rrugëve dhe toponoimeve në zonat ku tradicionalsht jetojnë, përdorimi i gjuhës, kontaktet me anëtarët e komunitetit brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja në organizata jo-qeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Themelimin e organizatave të ndryshme, etj. Duhet thënë se disa prej atyre që kanë natyrën kushtetutese janë të paraqitura në Kushtetutë në mënyrë konkrete dhe në gjuhë juridike, ndërsa mënyra rregullohet me ligj. Neni 5 gjuhët zyrtare, neni 6 pika 2 simbolet. Pastaj punësimi në institucionet publike neni 61, 62, 64 pika 2 dhe 4, neni 64 pika 2, neni 77 pika 3, neni 78, neni 81, pjesëmarrja në ministri neni 96, në drejtësi 104 pika 3 dhe 6, 124, neni 126 pika 4, neni 128 pastaj neni 133, neni 139 dhe neni 144 pika 2. Këto që i përmendëm dhe ato që nuk i përmendëm, kontretizojnë Deklaratën e Pavarësisë dhe Konventave për mbrojtjen e pakicave në Evropë. Mbrojtja e pakicave dhe të drejtave të tyre është e drejtë

ndërkombëtare për mbrojtje të lirive të njeriut dhe paraqesin pjesë të marrëdhëneve ndërkombëtare. Normat e këtyre Konventave zbatohen në frymën e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve fqinjësore. Prej asaj që thamë deri më tash, rezulton një përfundim logjik se Kushtetua ofron një bazë të mirë për inkuadrim dhe mbrojtje të komuniteteve si dhe pjesë e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në fund, më lejoni të ju lus që të jepni mendimet e juaja me theks në temën që po diskutojmë si dhe në mënyrë të përshtatshme t'i dërgoni komentet e juaja për ta perfeksionuar Kushtetuën e Kosovës si dhe të gjithë ne të jemi bashkautor të kësaj Kushtetute.

### **Pyetjet / Komentet e Pjesëmarrësve:**

#### **ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME: PROCESI I KUSHTETUTËS**

1. **Pjesëmarrës:** Përshendes pjesëmarrësit në këtë tubim. Poashtu edhe anëtarët e Komisionit që janë duke përcjellur me kujdes zhvillim e Kushtetutës. Mendimi im është se kjo Kushtetutë është akti më i madh i Kosovës dhe ajo që me rëndësi është se është Kushtetutë e qytetarëve. Një lloj personifikimi që ekziston në Kushtetutë është Ombudspersoni. Një lloj “kontrollori” ta quaj ashtu, dhe mendoj se është me rëndësi që të jetë në Kushtetutë. Megjithëse, më intereson nëse ky funksion do të ketë të njëjtin rol, dhe si do të rregullohet?. Poashtu edhe neni 60 pika 1 dhe pika 2 rreth Këshillit Konsultativ për Komunitete. Nuk e kam të qartë nëse ky trup do të zgjedhet nga radhë të Kuvendit që kanë fituar legjitimitet apo organizata civile?. Kush e përben këtë Këshill të Komuniteteve?.

**Fatmir Fehmiu:** Institucioni i Ombudspersoni është zhvilluar në Suedi dhe është në gjuhën suedeze. Në disa vende përkthehet si Avokat i Popullit. Edhe tani kjo rregullohet me ligj. Sidoqoftë se do të rregullohet me ligj. Përfaqësuesit e asociacioneve të pakicave do të jenë pjesëtarë. Kush janë këto asociacione të komuniteteve. Mund ta konkretizojmë në kuptimin e precizimit. Për mua do të ishte e mirë të shprehur nëse do të formuloni se si do të duhet dukur në mënyrë më precize dhe konkrete. Megjithëse, unë e thashë se duhet ta kemi parasysh gjuhën kushtetuese.

2. **Pjesëmarrës:** A do të përbëhet ky Këshill nga pjesëmarrësit e partive politike që kanë fituar legjitimitet apo do të jetë civil.

**Bajram Latifi:** Asociacionet janë kuptim i gjërë dhe kjo paraqet organizatat civile.

3. **Pjesëmarrës:** Ju përshendes për këtë debat. Nuk e di se si është dhënë në shqip “Këshill” më duket për asociacione. Ky Këshill parashihet të formohet me Kushtetutë dhe do të duhet parashikuar të bëhet ligji: Ligji Kushtetues për pakicat. Sidoqoftë, ndoshta do të dal nga kjo Kushtetutë. Ky ligj do të përcaktojë se kush do të jetë në këtë Këshill. Ka ligje që e përcaktojnë shumë qartë se si do të duken këto Këshilla. Kishte dilema se këto Këshilla të jenë në kuadër të zyrës së Kryeminsitrit apo Presidentit. Ekzistojnë disa gjëra që nuk janë ndoshta të definuara qartë. Pjesët për pakicat janë marrë nga pakoja e Ahtisaarit dhe nuk mund të ketë ndryshime, përveç nëse iu jepen të drejta më të mëdha. Kemi futur pjesën e pakicave në nenin 5 mbi gjuhët që përbëjnë 5% të jetë gjuhë zyrtare. Kjo lidhet me gjuhët zyrtare se edhe gjuha boshnjake të jetë gjuhë zyrtare. Nëse lidhemi me interpretimin se ky nen na mundëson edhe edukimin në gjuhën e tyre, përveç që do të jetë gjuhë zyrtare. Një pyetje – a është formulim i mirë neni 4, “Kosova është Republikë demokratike, apo do të duhet të ishte Republikë Parlamentare”?.

**Bajram Latifi:** Kishte shumë sugjerime të mos jetë demokratike por parlamentare. Megjithëse, mbetet të diskutohet. Neni i parë është shumë me rëndësi, sepse të gjitha nenet fillojnë dhe lidhen me nenet tjera.

4. **Pjesëmarrës:** Përshendes të gjithë. Kushtetuta miratohet në një vend për të rregulluar një shtet. Në disa segmente të Kushtetuës që rregullon jetën e komuniteteve, e ka lënë që disa rregulla kanë të bëjnë me të drejta të fituara. Po nisem prej nenit 5, ku rregullohen gjuhët zyrtare e që janë shqip dhe serbisht. Derisa gjuhët tjera janë në përdorim apo që kanë të drejtë për përdorim zyrtar në vendet ku jetojnë dhe se rregullohet me ligj. Gjuha turke ishte rregulluar me ligj si gjuhë e barabartë me shqipen dhe serbishten në Kushtetuat paraprake duke përfshirë edhe Kushtetutën e Kaçanikut. Një realitet i ri është gjuha boshnjake e cila prezantohet si komunitet boshnjak dhe duhet të zhvillohet në Kosovë. Është mundësi e mirë që kanë të drejta të garantuara me Kushtetutë dhe ato mund t'i realizojnë. Neni 58 pika 6 do të duhej të fshihen fjalët “kundër vullnetit të tyre” sepse nuk mund të lejohet me Kushtetutë që ndonjë pjesëtar i komuniteteve të asimilohet. Të paktën në Kushtetutë nuk mund të lejohet sepse është e ndaluar edhe me Konventat Ndërkombëtare. Të merret parasysh apo të bëhet një redaktim. Neni 59 pika 3 veç u elaborua e që ka të bëjë me edukimin. Edhe në arsim nuk është paraparë e drejta e fituar. Nëse ky nen qendron kështu në Kushtetutë, atëherë duhet mbyllur këto degë që tashmë ekzistojnë në gjuhën boshnjake. Pyetje tjetër në lidhje me këtë çështje. Do të jetë dëmtuese nëse ky formulim qëndron kështu. Pika 6 nga neni 59, duhet shlyrë pjesa “popullatë të mjaftushme, sepse kufizohet e drejta individuale që do të thotë se mund ta përdorin gjuhën në institucione vetëm nëse përbëjnë numrin e mjaftueshëm. Ky nen është në kolezion me nenet 24 dhe 25 të kësaj Kushtetute. Nuk do të duhej që të rregullohen me përqindje, por të jetë më dorshirë.

Pika 11 neni 59, këtu po bëhet diskriminim, pakicës serbe i mundësohet një frekuencë e veçantë për kanal televiziv. Këtu do të duhej që edhe të tjerëve të iu ipet e njëjta mundësi, nuk mund ta ndani një komunitet prej tjetrit. Në Kushtetutë do të duhej të ndërtohet një nen ku do të thuhej se Kosova ka Gazetën Zyrtare dhe do të shtypet në gjuhët e komuniteteve. Duhet të rregullohet me Kushtetutë sepse infomrimi është me rëndësi për qytetarët.

Edhe diçka për mekanizmin mbrojtës për komunitetet. Këtu është i përfshirë por nuk është i përshtatshëm, për arsye se kemi komunitete të cilat kanë qenë kundër gjuhës boshnjake që të ekzistojë.

**Fatmir Fehmiu:** Në lidhje me nenin 58: tekstualisht është përshkruar nga neni 5 i Konventës për të Drejta Civile dhe Politike. Tekstualisht është përshkruar në Kushtetutë.

Ekzistojnë dy lloj të normave në teori: abstrakte dhe konkrete. Ajo konkrete ka të bëjë me vendosjen në mënyrë konkrete jetën dhe avancimin e saj. Të gjitha ligjet që nxjerren para Kushtetutës, ato duhet të harmonizohen me Kushtetutë.

**Bajram Latifi:** Ju lutëm, dërgoni komentet e juaja dhe sigurohuni që t'i mbrashtroni mirë. Poashtu, në fund Kushtetuta do të dërgohet në zyrën Civile Ndërkombëtare dhe ata nuk do të lejojnë që të ketë shkelje të planit të Ahtisaarit.

5. **Pjesëmarrës:** Përkrah parafolësin për heqjen e kësaj fjalie “kundër vullnetit të tyre në neni 58 pika 6”. Kemi praktikë në Kosovë se pakicat lehtë manipulohen.

Neni 59 pika 2. Meqë është përshkruar nga plani i Ahtisaarit në lidhje me arsimin. Pika 3 e demanton atë që u tha në fillim në lidhje me arsimin, sepse pika 3 ia mundëson shkollimin në gjuhën e tyre, por do të doja që në këtë pikë të shtohet edhe “në arsimin e lartë”. Poashtu edhe në pikën 2 të shtohet “se kanë mundësi të zgjedhjes në gjuhën zyrtare nëse nuk ekziston në gjuhën e tyre”.

Shteti i Kosovës duhet të marrë përgjegjësi për shkollim të lartë në gjuhën e tyre. Na duhet që poashtu të përkujdesemi për studentët që studiojnë në Sarajevë dhe ata në Turqi; çka me ata kur e

dimë se kanë shpenzime enrome?. Si do të kujdeset Kosova për këta njerëz?.

Poashtu në nenin 59 pika 12, të thuhet “institucionet” sepse janë insitucionet ato që lidhen në mes veti, ndërsa të hiqet “personat”

Më vjen mirë që me planin e Ahtisaarit është shtuar edhe gjuha boshnjake.

6. **Pjesëmarrës:** Iu bashkangjitem vërejtjeve të dhëna deri me tash. Pyetje rreth edukimit në gjuhën romë. Nuk është e paraparë dhe është me rëndësi të thuhet. Sa përfaqësohet në institucione komuniteti rom. Ajo që shoh është 10% e përfaqësimit të komuniteteve në nivel lokal. Megjithëse nga praktika RAE është në pozitë të vështirë sa i përket përfaqësimit. Duhet ta kemi parasysh se edhe këto komunitete të jenë të përfaqësuara në të gjitha nivelet. T’i keni parasysh vërejtjet e dhëna nga Këshilli i Evropës, OSBE dhe orgnaizatrat nga komunitetet RAE mbi përfaqësimin e dobët që e kanë. Ne, në nivel të komunës nuk kemi asnjë përfaqësues.

**Bajram Latifi:** Përkrah sugjerimin që u dha. Dërgojeni ju lutem në formë të shkruar.

7. **Pjesëmarrës:** Përshendes organizatorin dhe pajtohem me diskutimet e mëparshme. Por nuk e di nëse do të ketë efekt dhe do të përfshihen në Kushtetutë. Neni 1, thotë “Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik, dhe i pandashëm: fjala “Republika” është pjesë përbërëse e një vendi, poashtu do të doja nga ju sqarim për nenin 3 “shoqëri multietnike”, nuk e kam të qartë, a ekziston në Botë një shtet i tillë. Pastaj është shtet sekular, a ka ndonjë shembull tjetër në Botë të tillë?

**Bajram Latifi:** Sa i përket vërejtjes së parë. Të gjitha Republikat e përmbajnë këtë fjalë. Ndërsa, sa i përket seuklares, është me rëndësi të thuhet se pavarësia e shtetit është e ndarë nga feja. Republika me këtë ndahet nga feja. Kemi modele të shumta, p.sh. Turqia, Franca etj.

8. **Pjesëmarrës:** Kosova është shtet për shkak se është multietnike. Unë si komunitet turk, nuk e di a t’i gëzohem kësaj Kushtetute apo jo. Pika 5 me të cilën nuk po pajtohem është ajo që ka të bëjë me arsimin. Por të gjitha këto kanë të bëjnë me pakon e Ahtisaarit. A do të kontribuojë kjo me asimilim apo zhvendosje të turqëve? Nuk e di nëse Ahtisaari ka menduar për këtë. Atëherë çfarë multietniciteti do të ketë Kosova. Përkrah atë që u tha se bashkëpunimi të jetë me “Institucione” dhe jo “persona”.

**Bajram Latifi:** Puna e “personave” ka të bëjë me persona juridik, fizik dhe grupe më të gjëra, dhe është një përkufizim shumë më i gjërë.